

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Shërbimi internetit Linja AKSHI”, i ndarë në lote:

- **Loti 1 – Shërbimi Internetit Linja 1 AKSHI.**
- **Loti 2 – Shërbimi Internetit Linja 2 AKSHI.**
- **Loti 3 – Shërbimi Internetit Linja 3 AKSHI.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

32412000- 4 Rrjet i komunikimeve

**VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL: 6,732,282** (gjashtëmilion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**

- ***Loti 1 – Shërbimi Internetit Linja 1 AKSHI***, me fond limit: **2,244,094** (dymilion e dyqind e dyzet e katër mijë e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**
- ***Loti 2 – Shërbimi Internetit Linja 2 AKSHI***, me fond limit: **2,244,094** (dymilion e dyqind e dyzet e katër mijë e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**
- ***Loti 3 – Shërbimi Internetit Linja 3 AKSHI***, me fond limit: **2,244,094** (dymilion e dyqind e dyzet e katër mijë e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, Terma reference etj. dhe llogaritja e Fondit Limit, janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor perfitues, i cili kërkon realizimin e shërbimit.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më vogël se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. (*Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*)

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit (per secilin lot) të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, e LPP-së, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

*Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 55, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

#### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 19 % e vlerës së përlllogaritur të objektit që prokurohet

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës..” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit (per secilin lot) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim të Përgjithshme nga AKEP për shërbimet e ofruara.

**Argumentimi:** Ky kriter mbeshtetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i pajisur me Autorizim të Përgjithshëm nga AKEP është një kërkesë thelbësore dhe e domosdoshme për garantimin e ligjshmërisë së ushtrimit të aktivitetit të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me furnizimin me internet të Datacenter-it të AKSHI-t, i cili përfaqëson një infrastrukturë kritike shtetërore dhe mbështet funksionimin e sistemeve dhe shërbimeve elektronike publike, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet që operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Kjo kërkesë garanton që operatori ekonomik është subjekt i licencuar dhe i monitoruar nga autoriteti kompetent rregullator, disponon të drejtën ligjore për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe zotëron kapacitetet minimale teknike dhe administrative të kërkuara për ofrimin e shërbimeve të internetit. Për më tepër, kërkesa konsiderohet proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi nuk vendos kufizime artificiale të konkurrencës, por synon të garantojë që shërbimi të ofrohet nga operatorë të autorizuar dhe të rregulluar sipas legjislacionit sektorial.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 9001:2015 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001:2015 justifikohet me nevojën për të garantuar që shërbimet objekt prokurimi do të ofrohen nëpërmjet proceseve të standardizuara të menaxhimit të cilësisë. Furnizimi me internet për Datacenter-in e AKSHI-t nuk përbën një shërbim të zakonshëm komercial, por një shërbim me rëndësi të veçantë për funksionimin e sistemeve shtetërore dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve publike elektronike.

Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet që operatori ekonomik disponon procedura të dokumentuara dhe mekanizma kontrolli për menaxhimin e cilësisë së shërbimit, trajtimin e incidenteve, monitorimin e performancës dhe garantimin e vazhdimësisë operative. Certifikimi ISO 9001:2015 dëshmon se operatori ekonomik operon sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë dhe ka ngritur procese të kontrolluara dhe të audituara për ofrimin e shërbimeve të tij.

Kjo kërkesë është në raport të drejtë me rëndësinë dhe kompleksitetin e kontratës, pasi synon të minimizojë riskun e problematikave operative dhe të garantojë që shërbimi i internetit të ofrohet në mënyrë të qëndrueshme dhe me standarde të larta cilësie.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 27001:2013 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë

*të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

*Kërkesa për certifikim ISO 27001:2013 lidhet drejtpërdrejt me garantimin e sigurisë së informacionit dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike digjitale të administratës shtetërore. Duke qenë se Datacenter-i i AKSHI-t përmban dhe mbështet sisteme të rëndësishme të veçantë për ofrimin e shërbimeve elektronike publike, çdo ndërprerje, komprometim apo cenim i sigurisë së lidhjes së internetit mund të ndikojë drejtpërdrejt në funksionimin e sistemeve shtetërore dhe në disponueshmërinë e shërbimeve për qytetarët dhe institucionet.*

*Në këtë kuadër, autoriteti kontraktor ka detyrimin të sigurohet që operatori ekonomik disponon politika, procedura dhe kontrole të standardizuara për menaxhimin e sigurisë së informacionit, menaxhimin e riskut, trajtimin e incidenteve të sigurisë dhe garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së shërbimeve të komunikimit. Certifikimi ISO 27001:2013 përbën një standard ndërkombëtar të njohur për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe garanton që operatori ekonomik operon mbi bazën e praktikave të konsoliduara të sigurisë.*

*Kjo kërkesë konsiderohet proporcionale me objektin e prokurimit dhe lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë kritike të infrastrukturës që do të mbështetet nga ky shërbim.*

**2.3.6** Numri aktual i “Peer” që operatori duhet të disponojë si Uplink për daljen e tij në internet nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre), ku nga keto 3 duhet që të ketë të paktën (2) dy “Peers” me provider AS të regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë. Shërbimi me secilin prej 3 operatoreve duhet të dëshmohet me anë të kontratës përkatëse si edhe të jetë i verifikueshëm nëpërmjet Databazës së “RIPE NCC”.

**Argumentimi:** *Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

*Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 3 “Peers” për daljen në internet, ku të paktën 2 prej tyre të jenë me provider AS të regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë, justifikohet me nevojën për garantimin e redundancës, vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimit të internetit për Datacenter-in e AKSHI-t.*

*Duke qenë se Datacenter-i mbështet sisteme kritike shtetërore dhe shërbime elektronike publike, është e domosdoshme që lidhja me internetin të mos mbështetet në një operator apo një rrugë të vetme komunikimi, pasi kjo do të krijonte risk të lartë për ndërprerje të shërbimit në rast problematikash teknike, dështimesh infrastrukturore apo incidenteve në rrjetet upstream. Kërkesa për disa peers dhe për uplink ndërkombëtarë synon të garantojë diversitet të routing-ut, redundancë të lidhjeve dhe mundësi automatike failover në rast problematikash në një nga rrugët e komunikimit.*

*Gjithashtu, kërkesa që këto lidhje të jenë të verifikueshme në databazën e RIPE NCC dhe të mbështeten me kontrata përkatëse synon të garantojë objektivitetin dhe verifikueshmërinë e kapaciteteve teknike të deklaruara nga operatori ekonomik. Ky kriter konsiderohet proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për garantimin e disponueshmërisë së lartë të shërbimit për infrastrukturën kritike shtetërore.*

**2.3.7** Operatori ekonomik për zbatimin e kontratës duhet të ketë të punësuar në stafin e tij jo më pak se 5 (pesë) punonjës (*per njerin nga lotet qe oferton*), të diplomuar në fushën e Telekomunikacionit, Elektronikë, Informatike, Teknologji Informacioni dhe/ose Elektrike, të cilët do të kryejnë shërbimin instalimit, konfigurimit dhe mirëmbajtjen e shërbimit, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** *Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 5 punonjës të diplomuar në fushat e Telekomunikacionit, Elektronikës, Informatikës, Teknologjisë së Informacionit dhe/ose Elektrikes justifikohet me kompleksitetin teknik të implementimit dhe mirëmbajtjes së shërbimit objekt prokurimi, është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE, e cila ka në objektin e tij tregtar këtë natyrë shërbimi. Furnizimi me internet për Datacenter-in e AKSHI-t kërkon instalim, konfigurim, monitorim, administrim të pajisjeve dhe lidhjeve të komunikimit, si dhe ndërhyrje të specializuara në rast incidentesh apo problematikash teknike.*

*Për shkak të rëndësisë kritike të shërbimit, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet që operatori ekonomik disponon staf të mjaftueshëm teknik dhe me kualifikimin e duhur profesional për të garantuar zbatimin korrekt të kontratës dhe vazhdimësinë e shërbimit. Kjo kërkesë synon të*

*vërtetohet kapacitetin real teknik dhe operacional të operatorit ekonomik për të përmbushur detyrimet kontraktore në mënyrë profesionale dhe të qëndrueshme.*

*Numri minimal prej 5 specialistësh konsiderohet proporcional me objektin dhe rëndësinë e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin që shërbimi do të mbështesë infrastrukturë kritike shtetërore dhe do të kërkojë mbulim të vazhdueshëm teknik për monitorim, mirëmbajtje dhe ndërhyrje operative.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi e punës i caktuar nga titullari e AK-së përfitues AKSHI, bazuar në nevojat e të cilës, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor Përfitues.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST

*Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të shërbimeve objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**